Kronikë

VIDEO/ Me shotgun duke ruajtur parcelën e kanabisit në Malësi të Madhe, në kërkim 51-vjeçari! 3 në pranga, asgjësohen 161 bimë narkotike

Një parcelë kanabisi është zbuluar në Malësi të Madhe, ndërsa është shpallur në kërkim një 51-vjeçar, i cili është filmuar nga policia duke ruajtur serën i armatosur. Në pranga kanë rënë tre persona të tjerë, ndërsa janë asgjësuar 161 bimë narkotike cannabis sativa.

HOROSKOPI

Lajmi i fundit

Ndryshimi i formatit të Superligës, Armand Duka zbulon skemën e preferuar: Ndeshjet do luhen në 'Air Albania', të kthehen në derbi

8 Korrik, 10:48

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
8 Korrik, 10:09 | **Përditesimi: 8 Korrik, 10:41**

MALËSI E MADHE- Lek Kokaj, 51 vjeç, është filmuar nga autoritetet policore teksa ruante i armatosur një parcelë kanabisi në Malësi të Madhe. Ai është filmuar nga pajisje inteligjente dhe duket teksa në shpinë mban një shotgun dhe ruan parcelën e kanabisit, ndërsa në disa momente edhe ujit bimët narkotike.

Uniformat blu duket se i kanë pasur nën monitorim prej disa ditësh grupin prej 3 personash që kishte kultivuar lëndët narkotike, pasi në video e ndarë shihen momente të 51-vjeçarit që ruan parcelën gjatë natës, por edhe ditën, ku në më pas në pamje dallohen edhe një person tjetër, teksa ecnin nëpër parcelë. Policia ka asgjësuar 161 bimë narkotike në parcelën në fshatin Ivanaj, njësia administrative Kastrat.

LEXO EDHE:
Festivali i fëmijëve, gjirokastritja rrëmben çmimin e parë! Fituesja: Këngën ia dedikoj qenit që ka ngordhur

Dy bashkëpunëtorët e kultivimit të kanabisit kanë rënë në pranga, konkretisht Gjergj Dragani, 51 vjeç, dhe Florjan Gjerkaj, 35 vjeç. Pavarësisht filmimit, policia nuk ka rritur të kapë Lek Kokaj, i cili është shpallur në kërkim. Ky i fundit akuzohet për vepra penale "Kultivimi i bimëve narkotike", kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".

Nga ana tjetër, Dragani akuzohet për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike", kryer në bashkëpunim", ndërsa Gjerkaj akuzohen për "Kultivimi i bimëve narkotike", kryer në bashkëpunim, dhe "Përkrahja e autorit të krimit".

Po ashtu, është arrestuar edhe 70-vjeçati Luli Gjerkaj për moskallëzim krimi. Ai kishte dijeni për rastin dhe nuk ka kallëzuar krimin, pasi në pronën e tij kalonte tubi i ujit që përdornin 3 bashkëpunëtorët, për të vaditur bimët narkotike.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:19

VIDEO/ Me shotgun në shpinë, ja si ruante parcelën e kanabisit 51-vjeçari në Malësinë e Madhe

Në këtë video shihet se si një 51-vjeçar ruan i aramtosur parcelën me kanabis në Malësi të Madhe, ku bashkë me dy persona të tjerë kishin kultivuar 161 rrënjë kanabis. Me armë në shpinë, Lek Kokaj është filmuar nga pajisjet inteligjente të policisë teksa ruante parcelën, apo ujiste bimët narkotike.

Ai është shpallur në kërkim, ndërsa në pranga kanë rënë edhe bashkëpunëtorët e tij Gjergj Dragani, Florjan Gjerkaj dhe Luli Gjerkaj. Ky i fundit është arrestuar për 'Moskallëzim Krimi'.

SI.E./Shqiptarja.com

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: kultivim kanabisi | kanabis | Luli Gjerkaj | Florjan Gjerkaj | Gjergj Dragani | Lek Kokaj | Shkoder | malesi e madhe

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Pas dhunës për guroren a duhet të japë doreheqjen deputeti Rrahman Rraja?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Hidhet guri i parë i themelit të kishës së re të Shën Gjinit në Vermosh
Ergys Kavaja
7 Korrik, 14:53

Gjenden 894 bimë kanabisi të kultivuara në fshatrat e Kukësit, nën hetim 4 persona
7 Korrik, 10:13

VIDEO/ Aksident i rëndë në Dukagjin të Shkodrës, fuoristrada bie në humnerë! Shoferi në gjendje të rëndë
6 Korrik, 17:20

Asgjësohen 70 bimë narkotike në Manzë të Durrësit, në pranga 3 të rinj
6 Korrik, 12:34

Vllaznia rikthen në ekip ish-kapitenin, më shumë forcë për Memellin
6 Korrik, 10:19

Ujiste bimët e kanabisit në këmbim të ushqimit, burg për shqiptarin në Holandë
5 Korrik, 18:47

Asgjësohen 1541 kanabis në 3 fshatra të Lezhës, s'dihen autorët
5 Korrik, 14:06

VIDEO/ Shpërndante kanabis me doza, arrestohet 47-vjeçari në Lushnjë
5 Korrik, 09:34

Zbulohen dhe asgjësohen parcelat me kanabis, në Kurbin arrestohet kultivuesi, në Lezhë s'dihen autorët
4 Korrik, 13:46

Beteja kundër kanabisit, 96 mijë rrënjë të asgjësuara në 6 muajt e parë të 2023! Problematike Mirdita, Kurbini, Kruja, Vau Dejës
Sokol Dema
2 Korrik, 21:09

Vrasja e babë e bir në Dukagjin, shkak dyshohet një sherr i ndodhur një vit më parë mes 57-vjeçarit dhe një bashkëfshatari
3 Korrik, 12:21

Autoritetet greke zbulojnë plantacionin e kanabisit në kufi me Shqipërinë! Sekuestrohen 1850 fidanë, asnjë gjurmë nga autorët
1 Korrik, 13:43

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje